Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>4</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



---

## Shtojca 2.

*[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllorarit çmimin bazuar në:**

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

**Shtojca 3.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

#### Shtojca 4.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 5.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

---

## Shtojca 6.

### LOTI 1- “BLERJE MATERIALE TË BUTA” PËR NJËSINË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR SHKODËR

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

*b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*

*c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

### LOTI I “BLERJE MATERIALE TË BUTA”

#### 1. DYSHEK TEK ORTOPEDIK

Dysheku tek Ortopedik duhet të plotësojë kërkesat standarde të mëposhtme për tu përdorur në spitale. Njëra anë e dyshekut duhet të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit. Ky konstruksion i

veçantë i sipërfaqes lejon ventilim më të mirë, duke e mbajtur temperaturën e trupit konstante, siguron lëvizje më të lirshme të pacientëve dhe rehati.

Dysheku tek ortopedik duhet të ketë konstrukcion anatomik dhe të përbëhet nga dy shtresa të forta sfungjeri (foam). Në pjesën e sipërme të dyshekut duhet të vendoset shtresa e sfungjerit memory që siguron shpërndarjen, lehtësimin e pikave të presionit dhe konformitetin me të madh. Sfungjeri duhet të ketë mbrojtje antimikrobiale dhe të jetë rezistent ndaj flakes.

Pesha e dyshekut është rreth 10.8 kg. Pjesa e sipërme është sfungjer viskoelastik me dendësi 60 kg/m<sup>3</sup> dhe lartësi 5 cm. Pjesa e poshtme është mbështetje sfungjeri me rezistencë të lartë 30 kg / m<sup>3</sup> dhe lartësi 10 cm. Ky dyshek duhet të sigurojë që të mbajë peshën e një personi deri në 120 kg.

Dysheku duhet të përdoret gjithmonë me mbulesën e tij/astarin e tij dhe të dy duhet të kenë këto karakteristika:

- me veti kundër zjarrit i certifikuar me Klasën 1.
- me veti antibakteriale dhe antialergjike.
- me veti antimikrobiale dhe antistatike.
- i papërshkueshëm nga uji dhe me aftësi të larta ajërosëse.
- të rezistojnë temperaturave të larta të pastrimit dhe sterilizimit.

***Përbërja:***

Astari /mbulesa e dyshekut duhet të jetë i veshur nga jashtë (i trajtuar) me mbulesë të fortë të padepërtueshme nga lëngjet biologjike (acidi urik, njollat e gjakut, etj) dhe uji. Kellefi astar i dyshekut ka katër faqe (faqen e sipërme, dy faqet anësore dhe faqen e poshtme). Tekstili i përdorur për faqen e poshtme të astarit është i ndryshëm nga tekstili i astarit në faqen e sipërme dhe ato anësore.

Faqja e poshtme e astarit duhet të jetë me material kundër rrëshqitjes me përbërje 100 % Polipropilen. Faqja e sipërme dhe anësoret duhet të jenë prej materiali bioelastik me strukturë mikroporoze, me aftësi të lartë ajërosëse dhe të ketë përbërje 50 % Poliester + 50 % Poliuretan. Astari i dyshekut duhet të jetë i pajisur me zinxhir në të tre anët e tij. Zinxhiri duhet të qepet në bordin e poshtëm të astarit dhe të mbulohet me një palë për të parandaluar infiltrimin e lëngjeve brenda dyshekut.

***Ngjyra e sfungjerit*** të jetë e bardhë ose ngjyrë kremi. Ngjyra e astarit të jetë sipas kërkesave të AK.

***Përmasat e dyshekut:*** Përmasat 200 x 90 x 15 cm.

***Kushte të domosdoshme:***



Dysheku dhe mbulesa e tij duhet të prodhohen me materiale të cilësisë së parë, nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut, AZO ngjyrues, duhet të jenë jo-toksike, jo-kancerogjene, jo-alergjike dhe të afta të sterilizohen pa pësuar më tej ndryshime kimike ose fizike. Dysheku duhet të jetë rezistent për një kohë të gjatë, dhe këllëfi i dyshekut duhet të pastrohet dhe të mirëmbahet lehtë. Gjatë pastrimit dhe mirëmbajtjes, dysheku nuk duhet të humbasë karakteristikat e tij ergonomike, mekanike dhe terapeutike.

<b>Karakteristika të këllëfit të dyshekut</b>		
<b>Vetite</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq 3-4$ ;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë $\geq 3$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse këllëfi i dyshekut është me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, në fërkim).

#### ***Veti shtesë***

- Qëndrueshmeria ndaj avujve të ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Dizinfektimi i sipërfaqes- Agjentët disinfektues të aplikuar duhet të identifikohen nga prodhuesi.

## **2. BATANIJE**

Batanijet duhet të sigurojnë ngrohtësi dhe rehati. Batanijet duhet të jenë higjienike, të buta, të rehatshme dhe që të lahen e sterilizohen lehtësisht.

#### ***Përbërja:***

- 60% lesh dhe 40% akrilik.

**Ngjyra:**Me ngjyrë kafe ose blu e lehtë.

**Përmasa:** 220 x 160 cm.

**Masa:** 800 - 900 gr/m<sup>2</sup> dhe e qepur në të katër anët.

<b>Karakteristika të batanijes</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
<b>Ndryshimi dimensional</b>		
Stabiliteti dimensional	Të endura: Baza $\pm 4\%$ , Indi $\pm 4\%$ ; Të thurura: gjatësia $\pm 10\%$ , gjerësia $\pm 10\%$	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 400$ N; Indi $\geq 400$ N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.

#### **Veti shtesë**

- Qëndrueshmëria ndaj avujve te ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Filli i ngjyrosur- Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).

### **3. JASTËKË KREVATI**

**Përmasat:** 80 x 50 cm.

**Masa:** 800gr/m<sup>2</sup>

**Ngjyra:** e bardhë.

Të jetë me mbushje sintetike uniforme.

#### **Veti shtesë**

- Qëndrueshmëria ndaj avujve te ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Dizinfektimi i sipërfaqes- Agjentët disinfektues të aplikuar duhet të identifikohen nga

---

prodhuesi.

#### **4. ÇARCAFË TEK TË SIPËRM**

***Përbërje:***

- 75% pambuk dhe 25% poliester.

***Ngjyra:*** Me ngjyrë sipas kërkesave të AK.

***Përmasat:*** 160 x 220 cm.

***Masa:*** 160-180 gr/m<sup>2</sup> dhe me qepje nga të katërta anët.

<b>Karakteristika të çarçafit tek të sipërm</b>		
<b>Vetite</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë $\geq 3$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
<b>Ndryshimi dimensional</b>		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$ , Indi $\pm 5\%$ ;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 400$ N; Indi $\geq 400$ N	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.
Efekt i Piling (pushëzimi) 2000 cikle	$\geq 4$ (pëlhurat e endura) $\geq 3$ (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

***Shënim:*** Nëse çarçafi tek i sipërm, është me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, në fërkim, në zbardhje dhe në djersë).

***Veti shtesë***

- Qëndrueshmëria ndaj avujve të ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.

- 
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
  - Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
  - Filli i ngjyrosur- Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).

## **5. ÇARCAFË TEK TË POSHTËM**

### ***Përbërje:***

- 75% pambuk dhe 25% poliester.

**Ngjyra:** Me ngjyrë sipas kërkesave të AK.

**Përmasat:** 90 x 200 x 15 cm.

**Masa:** 160-180 gr/m<sup>2</sup> dhe me qepje nga të katërta anët.

Çarçafi në të dy ekstremet të ketë të qepur llastik në mënyrë që të bëjë të mundur fiksimin e tij përreth dyshekut. Logoja e institucionit sipas kërkesës së AK.

<b>Karakteristika të çarçafit tek të poshtëm</b>		
<b>Vetite</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë $\geq 3$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
<b>Ndryshimi dimensional</b>		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$ , Indi $\pm 5\%$ ; Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 400$ N; Indi $\geq 400$ N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.
Efekt i Piling (pushëzimi) 2000 cikle	$\geq 4$ (pëlhurat e endura) $\geq 3$ (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

**Shënim:** Nëse çarçafi tek i poshtëm është me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, në fërkim, në zbardhje dhe në djersë).

## Veti shtesë

- Qëndrueshmeria ndaj avujve te ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Filli i ngjyrosur- Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).

## 6. KËLLËF JASTËKU

### Përbërje:

- 100% pambuk.

Ngjyra: Sipas kërkesave të AK.

Përmasat: 80 x 50 cm.

Masa: 160-180 gr/m<sup>2</sup>.

Karakteristika të këllëfit të jastëkut		
Vetite	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë $\geq 3$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
<b>Ndryshimi dimensional</b>		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$ , Indi $\pm 5\%$ ; Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri - 5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmeria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 400$ N; Indi $\geq 400$ N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.

Efekt (pushëzimi) Piling 2000 cikle	$\geq 4$ (pëlhurat e endura) $\geq 3$ (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

**Shënim:** Nëse këllëfi i jastëkut është me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, në fërkim, në zbardhje dhe në djersë).

#### **Veti shtesë**

- Qëndrueshmëria ndaj avujve të ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Filli i ngjyrosur- Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës si produkti bazë (për produktet me ngjyrë).

## **7. PESHQIRË DUARSH**

#### ***Përbërja:***

- 100% pambuk.

**Ngjyra:** Me ngjyra të ndryshme sipas kërkesave të AK-së.

**Përmasa:** 90x 50 cm dhe me thurje me vjega.

**Masa:** 350- 400g/m<sup>2</sup>.

<b>Karakteristika të Peshqirit</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë $\geq 3$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Stabiliteti dimensional	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$ , Indi $\pm 5\%$ ;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.



Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 300$ N; Indi $\geq 300$ N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.
--	--	---

**Shënim:** Nëse peshqirët e duarve janë me ngjyrë të bardhatëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, fërkim).

**Veti shtesë**

- Aftesia për tu njomur - Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesorët - Konstruksioni, aksesorët dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Ndryshimi dimensional-Informacioni për hyrjen e pritur të peshqirit duhet të sigurohet nga prodhuesi.

**8. PESHQIRË BANJO**

**Përbërja:**

- 100% pambuk.

**Ngjyra:** Me ngjyra të ndryshme sipas kërkesave të AK-së.

**Përmasa:** 150 x 80 cm.

**Masa:** 350- 400g/m<sup>2</sup>.

<b>Karakteristika të Peshqirit</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë $\geq 3$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Stabiliteti dimensional	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$ , Indi $\pm 5\%$ ;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 300$ N; Indi $\geq 300$ N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse peshqirët e banjës janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, fërkim).

***Veti shtesë***

- Aftesia për tu njomur - Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Ndryshimi dimensional-Informacioni për hyrjen e pritur të peshqirit duhet të sigurohet nga prodhuesi.

## **9. KËLLËF DYSHEKU (I GOMUAR)**

***Përbërja:***

- Material nga njëra anë pambuk dhe nga ana tjetër i gomuar impermeable (i papërshkueshëm nga uji).

***Përmasa:*** 200 cm x 90 cm x 20 cm dhe qepje me llastik për të futur dyshekun.

***Qëndrueshmëria ndaj depertimit të ujit***- Treguesit e vlerave nga prodhuesi (300 cm).

***Veti shtesë***

- Qëndrueshmëria ndaj avujve të ujit- Treguesit e vlerave nga prodhuesi.
- Vetitë e shëndetit dhe të sigurisë- Sipas normave europiane dhe/ ose kombëtare.
- Prodhimi + aksesoret - Konstruksioni, aksesoret dhe prodhimi duhet të jenë të përshtatshëm për produktin dhe përdorimin e destinuar.
- Dizinfektimi i sipërfaqes- Agjentët disinfektues të aplikuar duhet të identifikohen nga prodhuesi.

## **10. MBULESË TAVOLINE NGRËNIE**

***Përbërja:***

- 65 % pambuk (CO) dhe 35 % poliester (PE)

***thurja:*** garniture.

***Masa:*** 200-210 g/m<sup>2</sup>.

---

**Përmasat e mbulesës:** 150 x 100 cm.

Dizenjo të ndryshme sipas kërkesës AK.

**Ngjyra:** Të jetë sipas kërkesës së AK.

<b>Karakteristika tëbatanijes</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota $\geq 4$	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

**Shënim:** Nëse mbulesa e tavolinës është me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje).

## **11. VESHJE KREVATI VIZITASH**

Mushama me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor

### **LOTI 2- “BLERJE VESHMBATHJE”:**

#### **1. BLUZA TË BRENDSHME PËR TË RRRITUR**

**Përbërja:**

- Të jenë material 100% pambuk, me jakë të rrumbullakët, me mëngë të gjata dhe të shkurtra.

**Ngjyra:** me ngjyrë të bardhë.

**Masa:** 160-180g/m<sup>2</sup>.

Bluzat të kënë përmasa të ndryshme sipas kërkesës AK.

#### **2. KOMPLET BIZHAME (PANTALLONA+XHAKETË)**

**Përbërja:**

- Të jenë material 100% pambuk.

**Ngjyra:** të ndryshme sipas kërkesës së AK-së.

**Masa:** 160-180g/m<sup>2</sup>.

Ato duhet të jenë të lehta, të rehatshme dhe miqësore me lëkurën. Pantallonat me llastik, xhaketa me jakë kemishë ose jakë V-je me kopsa përpara dhe dy xhepa. Pantallonat dhe xhaketa e bizhameve të kënë përmasa të ndryshme sipas kërkesës AK.

<b>Karakteristika të bizhameve</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq$ 4;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse bizhamet janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje).

### **3. TRIKO BURRASH**

#### ***Përbërja:***

- Të jenë prej materiali 50% Akrilik (PAN) dhe 50% Lesh (WO), methurje trikotazh indi.

**Ngjyra dhe përmasat:** Të jenë të ngjyrave dhe përmasave të ndryshme sipas kërkesës së AK.

*Triko te jetë me jakë në formë V-je dhe me kopsa.*

<b>Karakteristika të trikove</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq$ 4;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse trikot janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje).

---

#### **4. TRIKO GRASH**

***Përbërja:***

- Të jenë prej materiali 50% Akrilik dhe (PAN), 50% Lesh (WO), methurje trikotazh indi.

***Ngjyra dhe përmasat:*** Të jenë të ngjyrave dhe përmasave të ndryshme sipas kërkesës së AK

*Triko të jetë me jakë të rrumbullakët të mbyllura.*

<b>Karakteristika të trikove</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmëria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq 4$ ;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse trikot janë me ngjyrë të bardhë atëherë qëndrueshmëria e ngjyrës në larje nuk do të kërkohet.

#### **5. KANATJERE BURRASH DHE GRASH**

***Përbërja:***

- Të jetë material 100% pambuk methurje ind i thjeshtë.

***Masa:*** 150-160g/m<sup>2</sup>.

***Ngjyra:*** Të bardha.

Të jetë Nr i ndryshëm sipas kërkesës së AK.

#### **6. RROBDESHANË BANJO (BURRASH/GRASH)**

***Përbërja:***

- Të jenë material peshqir 100% pambuk.

***Masa:*** 350-400g/m<sup>2</sup>

***Ngjyra:*** Të jetë sipas kërkesave të AK-së.

Të jetë Nr i ndryshëm sipas kërkeses së AK.

<b>Karakteristika të rrobëdeshanëve</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq$ 4;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse rrobëdeshanët janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje).

## **7. KOSTUME VERORE BURRASH**

### ***Përbërja:***

- Të jenë material me përbërje 50% lesh dhe 50% poliester.

**Masa:** 180-200g/m<sup>2</sup>.

**Ngjyra dhe përmasat:** Ngjyra dhe përmasat e kostumit sipas kërkesës së AK.

<b>Karakteristika të kostumeve</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq$ 4;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse kostumet janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje).

## **8. KOSTUME VERORE GRASH**

### ***Përbërja:***

- Të jenë material me përbërje 50% lesh dhe 50% poliestër.

*Masa:* 180-200g/m<sup>2</sup>.

*Ngjyra dhe përmasat:* Ngjyra dhe përmasat e kostumit sipas kërkesës së AK.

<b>Karakteristika të kostumeve</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq$ 4;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.

Shënim: Nëse kostumet janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje).

## **9 . ÇORAPE**

*Përbërja:*

- 95% pambuk dhe 5 % spandex.

*Ngjyra:* Ngjyra dhe numri sipas kërkesave së AK.

## **10. PANDOFLA VERORE (BURRASH/GRASH)**

*Përbërja:*

- Të jenë material plastik me gomë poroze dhe pjesa e përparme e mbyllur me vrima për ajrosje. Materiali të jetë antirrëshqites, rezistent ndaj gërryerjes së vajit dhe i padepërtueshëm nga uji .

*Ngjyra:* Të jenë me ngjyre jeshile, të bardha ose blu dhe me numra të ndryshëm sipas kërkesës së AK.

Të jenë burrash/grash sipas kërkesës së AK.

## **11. KOSTUM DIMËROR**

### ***Përbërja:***

- Të jetë material stof 45% lesh dhe 55% poliester,thurje e plotë. Për burrat xhaketa monopet me dy kopsa, me 3 xhepa të jashtëm dhe dytë brendshëm. Pantallonat me zinxhir, me dy xhepa anësore dhenjëmbra me kopse, në tëdjathtë. Për gratëxhaketa monopet me dyxhepatë jashtëm të fshehtë, fundi I drejtë me një tëçarëmbra padhe me qemer. Numratsipas kërkesës sëAK.

**Ngjyra:** Ngjyra sipas kërkesës së AK.

**Masa:** 270-290 g/m<sup>2</sup>.

<b>Karakteristika të kostumit</b>		
<b>Vetitë</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</b>
<b>Qëndrueshmeria e ngjyrës</b>		
Larje 40°C	Nota $\geq 4$ ;	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 4$ Në të njomë $\geq 3-4$	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.

**Shënim:** Nëse kostumet dimërore janë me ngjyrë të bardhë atëherë nuk do të merret në konsideratë pjesa e karakteristikave që përcaktojnë qëndrueshmërinë e ngjyrës (në larje, fërkim).

## **12. BLUZË BURRASH DHE GRASH**

### ***Përbërja:***

- 65% Pambuk dhe 35% Poliester.

**Ngjyra:** Me ngjyrë sipas kërkesës së AK.

**Masa:** 130-140 gr/m<sup>2</sup>.

Të jenë me nr të ndryshëm sipas kërkesës së AK.



---

### **13. DOREZA PUNE**

Doreza pune blu material pambuku të veshura me gomë ngjyrë blu që përdoren në ndërtim dhe kopshtari në sajë të dendësisë së lartë të gomës duke bërë të mundur një mbrojtje maksimale nga mjetet e forta.

## LOTI 1- "BLERJE MATERIALE TË BUTA" PËR NJËSINË VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR SHKODËR

### Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

LOTI I: "BLERJE MATERIALE TE BUTA"			
NR	EMERTIMI ARTIKUJVE	I NJESIA	Sasitë e pritshme
1	Dyshek tek ortopedik	Copë	25
2	Batanije	Copë	70
3	Jastëkë krevati	Copë	70
4	Çarçafë tek të sipërm	Copë	80
5	Çarçafë tek të poshtëm	Copë	80
6	Këllëf jastëku	Copë	150
7	Peshqirë duarsh	Copë	150
8	Peshqirë banjo	Copë	100
9	Këllëf dysheku (i gomuar)	Copë	50
10	Mbulesë tavoline ngrënie	Copë	22
11	Veshje krevati vizitash	Copë	5

**Afati i Lëvrimit:** Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të minikontratave brenda afatit 12 mujor të marrëveshjes kuadër.

**Vendi ku do të kryhet lëvrimi i mallit:** *Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër* adresë:  
Rr:Bujar Bishanaku,Shkodër.

## LOTI 2- “BLERJE VESHMBATHJE”

### Shtojca 7.

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

NR	EMERTIMI I ARTIKUJVE	Njësia	Sasitë e pritshme
1	Bluza të brendshme për të rritur	<b>Copë</b>	<b>45</b>
2	Komplet bizhame (pantallone+XHAKETË)	<b>Copë</b>	<b>15</b>
3	Triko burrash	<b>Copë</b>	<b>25</b>
4	Triko grash	<b>Copë</b>	<b>25</b>
5	Kanatjere burrash dhe grash	<b>Copë</b>	<b>100</b>
6	Rrobdeshane banjo (burrash/grash)	<b>Copë</b>	<b>1</b>
7	Kostume verore burrash	<b>Palë</b>	<b>19</b>
8	Kostume verore grash	<b>Palë</b>	<b>19</b>
9	Çorape	<b>Palë</b>	<b>201</b>
10	Pandofla verore (burrash/grash)	<b>Palë</b>	<b>100</b>
11	Kostum dimëror	<b>Palë</b>	<b>15</b>
12	Bluzë burrash dhe grash	<b>Copë</b>	<b>9</b>
13	Doreza pune	<b>Palë</b>	<b>80</b>

**Afati i Lëvrim:** Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të minikontratave brenda afatit 12 mujor të marrëveshjes kuadër

**Vendi ku do të kryhet lëvrimi i mallit:** *Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër* adresë:  
Rr:Bujar Bishanaku,Shkodër.

---

# LOTI 1- “BLERJE MATERIALE TË BUTA” PËR NJËSINË VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR SHKODËR

## Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
  
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
  
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
  
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të

jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**2.3.2** OE ekonomik ofertues do të plotësojë deklaratën si më poshtë vijon, e cila do të jetë pjesë e zbatimit të kontratës.

LOTI I: "BLERJE MATERIALE TE BUTA "				
NR	EMERTIMI ARTIKUJVE	I	NJESIA	ORIGJINA E MALLIT (PRODHUESI)
1	Dyshek tek ortopedik		Copë	
2	Batanije		Copë	
3	Jastëkë krevati		Copë	
4	Çarçafë tek të sipërm		Copë	
5	Çarçafë tek të poshtëm		Copë	
6	Këllëf jastëku		Copë	
7	Peshqirë duarsh		Copë	
8	Peshqirë banjo		Copë	
9	Këllëf dysheku (i gomuar)		Copë	
10	Mbulesë tavoline ngrënie		Copë	
11	Veshje krevati vizitash		Copë	

**2.3.3** Operatori ekonomik, për artikullin Nr. (1) *“Dyshek tek ortopedik”* duhet të lëshojë një deklaratë garancie minimumi për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e lëvrimit të mallit objekt prokurimi.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 për “Sistemin e menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente (e vlefshme) dhe të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete analizat/raport testimet e lëndes se pare nga laboratorë zyrtarë të referencës ose të akredituar (vendas ose të huaj) sipas legjislacionit në fuqi per zerat 2) batanije, 4) çarcaf tek të sipërm, 6)këllëf jastëku dhe 7) peshqir duarsh.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



---

## **LOTI 2- “BLERJE VESHMBATHJE” PËR NJËSINË VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR SHKODËR**

### **Shtojca 8.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

